

# Tako Zotin

## Fotografitë

Gjatë udhëtimit tim të fundit në Rumani, bëra shumë fotografi, për t'i përdorur në disa artikuj që mendoja të shkruaja. Kur i mora fotografitë pas larjes, disa kishin dalë mirë, disa ishin jashtë fokusit dhe disa të tjera s'kishin dalë dhe aq mirë. I vendosa fotografitë në tavolinë dhe, pasi i rregullova, fillova t'i përzgjidhja.

Mësimi «Çdo njeri e ka një ditë të keqe ndonjëherë» u referohet «fotografive» nga Marta dhe Maria. Kjo seri, e titulluar «Tako Zotin», ka një sërë «fotografish» nga momentet e jetës së Jezusit. Me anë të këtij programi të studimit të Biblës gjatë vitit me ju, ne nuk mund t'ju tregonim *çdo gjë* për jetën e Krishtit. Ne shpresojmë se «fotografitë» e zgjedhura kanë treguar *diçka* nga veçantia e Tij dhe kanë ilustruar si mund të nxjerrësh mësim nga leximi i Biblës.

Tani që seria «Tako Zotin» po vjen drejt përfundimit, unë e pranoj se disa nga «fotografitë» që kisha planifikuar të përdorja nuk «u zhvilluan». Kur fillova të përgatisja këtë seri, unë iu ktheva mësimëve që predikova rreth Jezusit gjatë vitit 1992. Së pari kontrollova ato fjalime që më kishin pëlqyer dhe që ishin pritur mirë. Fatkeqësisht, disa nga shënimet e mia nuk ishin «të zhvilluara» mirë dhe disa të tjera nuk i kisha ruajtur. Të tjera mësimë që mund t'i kisha përdoruar janë lënë për numrat e tjerë të botimit.

Por, megjithatë, ka «fotografi» të mjaftueshme e të mira për qëllimin tonë. Unë i shpërndava, i shikova dhe fillova përzgjedhjen. Unë doja disa

mësime për jetën e Jezusit («Çdo njeri ka vlerë»), disa për mësimet e Jezusit («Gjithçka që kishte», «Shtatëdhjetë herë shtatë») dhe disa të tjera nga momente të ndryshme të jetës së Tij, në mënyrë të veçantë për vdekjen dhe ringjalljen e tij («Predikimi nga kryqi», «Rrugës për në Emaus»). Doja një a dy mësimë për njerëzit, jetët e të cilëve ndryshuan, sepse ata «takuan Zotin» («Mëkatari i vogël», «Kur këndon gjeli»). Unë doja mësimë për episodet më të njohura nga jeta e Jezusit («Ku janë nëntë të tjerët?», «Mësimet e peshqirit»), por edhe disa të tjera nga pasazhe më pak të njohura («A do të shërohesh me të vërtetë?»). Unë doja t'ju tregoja se si një pjesë e njohur mund të trajtohet në një mënyrë të re dhe si të zbulohen ide të reja që kjo pjesë ka («Njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin»). Unë madje doja një mësim për një nga «mësimet qortuese» të Jezusit, për të ilustruar se si mësimë të tilla mund të shpjegohen («Mësimi i Jezusit për “mëkatën e pafalshëm”»). Mbi të gjitha, unë doja mësimë që do të lavdëronin Jezusin («Jezusi është përgjigjja») dhe mësimë praktike («Çdo njeri e ka një ditë të keqe ndonjëherë»), që të shfrytëzoheshin prej secilit prej nesh.

Unë shpresoj se ju keni gjetur një a dy mësimë që mund t'i përdorni. Madje shpresoj se ndonjëri do të jetë i frymëzuar për të ndjekur programin vjetor të studimit të Biblës, të paraqitur në këtë seri. Predikimi gjatë një viti për Jezusin do të bekojë jetët tuaja. Sidoqoftë, shpresa ime

më e madhe nuk është që ta përdorni këtë material në klasë apo për të predikuar. Shpresa ime më e madhe është që, duke shikuar këto «fotografi», ju me të vërtetë të «takoni Zotin». Lutem që jeta juaj të influencohet dhe ndoshta të ndryshojë.

Sfida jonë e madhe këtu në «*E Vërteta për Sot*» (emri i institucionit që boton këto libra është të publikojmë mësimet që ndihmojnë studimin dhe kuptimin e gjithë Biblës. Meqenëse Testamenti i Vjetër është tre herë më i gjatë se Testamenti i Ri, shumë nga publikimet tona do të

jenë nga librat e Testamentit të Vjetër. Por, edhe në këto raste, shkrimtarët do të vënë në dukje se si këto libra tregojnë për Jezusin dhe rrugën e Tij. Ne përsëri besojmë se, që të përqëndrohemi aty ku duhet, herë pas here kemi nevojë për botime të veçanta për Krishtin. Ne shpresojmë se ju jeni dakord me këtë. Ku i dihet? Ndoshta disa nga «fotografitë e mia të pazhvilluara» do të jenë gati për mësimet e tjera.

David Roper,  
ndihmës redaktor pranë  
«*E VËRTETA PËR SOT*»

Autor: *David Roper*  
Marrë nga seria: “*Tako Zotin*”  
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara